



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 366 Akti

Nr. 446 Vendimi  
Tiranë, më 16.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Olsi Komici</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datat 7.9.2021, ora 13:00 dhe 14.9.2021, ora 13:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Adelina Zarka**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “E” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.**

**Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.**

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**V Ë R E N :**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Adelina Zarka është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dhe në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit Adelina Zarka u shortua në datën 16.12.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Valbona Sanxhaktari dhe anëtarë komisionerët Olsi Komici dhe Xhensila Pine. Vëzhgues ndërkombëtar i çështjes u caktua z. Tonci Petkovic.

3. Në datën 8.1.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të

interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisioneren Xhensila Pine.

4. Subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

6. Në datën 31.5.2021, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe, në vijim, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Adelina Zarka, vetëm për kriterin e pasurisë dhe në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

7. Komisioni njoftoi, nëpërmjet postës elektronike, subjektin e rivlerësimit Adelina Zarka për përfundimin e hetimit kryesisht dhe gjetjet e Komisionit, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.

8. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, subjekti ka kërkuar kohë shtesë për depozitimin e shpjegimeve dhe dokumentacionit për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, kërkesë e cila është pranuar nga trupi gjykues duke i dhënë kohë shtesë nga data 13.6.2021 në datën 27.6.2021.

9. Në përfundim të afatit subjekti paraqiti shpjegimet dhe provat (bashkëlidhur dhe raporte mjekësore deri në datën 19.7.2021). Gjithashtu, subjekti kërkoi rivlerësimin e saj mbështetur në të tria kriteret e rivlerësimit.

10. Komisioni pranoi dhe administroi provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Lidhur me kërkesën për hapjen e dy kriterëve të tjera të rivlerësimit, trupi gjykues nuk e ka pranuar atë deri në këtë fazë të hetimit, duke e njoftuar edhe subjektin e rivlerësimit.

11. Trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin në seancë dëgjimore në datën 26.7.2021, duke marrë në konsideratë raportet mjekësore të dërguara, si dhe duke i dhënë kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur. Komisioni ka njoftuar subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën e saj për të dërguar një përfaqësues ligjor në këtë seancë dëgjimore publike, nëse do ta vlerësonte të arsyeshme. Kjo seancë dëgjimore është njoftuar edhe publikisht.

12. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përsëri para datës së seancës dëgjimore rekomandime mjekësore për pushim 30-ditor. Komisioni ka njoftuar subjektin, si dhe publikun për shtyrjen e seancës dëgjimore në datën 7.9.2021, si dhe ka njoftuar subjektin se duhet të marrë masat për të marrë pjesë në seancën dëgjimore publike, sepse procesi i rivlerësimit është një proces me afat të përcaktuar dhe nuk mund të shtyhet pa limit.

13. Në datën 1.9.2021, subjekti i rivlerësimit ka informuar përsëri Komisionin se është me raport mjekësor dhe nëpërmjet postës elektronike ka paraqitur një tjetër raport deri në datën 17.9.2021, duke shprehur pamundësinë e pjesëmarrjes në seancën dëgjimore të datës 7.9.2021.

14. Komisioni ka informuar subjektin e rivlerësimit se do të zhvillojë seancën dëgjimore, pasi nuk mund t’i shtyjë pafundësisht, duke i kërkuar që nëse e vlerëson të arsyeshme të paraqesë një përfaqësues ligjor dhe se seanca dëgjimore do të njoftohet edhe publikisht.

15. Në datën 3.9.2021, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar përsëri Komisionin nëpërmjet postës elektronike se është e infektuar me virusin Covid-19 dhe nuk mund të marrë pjesë në seancën dëgjimore publike.

16. Komisioni ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit është një proces me afat të kufizuar në kohë dhe, si i tillë, nuk mund të shtyhet pafundësisht, duke vlerësuar se subjekti, në vijim, ka shtyrë disa herë seancat dëgjimore, për shkak të raportit mjekësor dhe se publiku, gjithashtu, duhet të informohet, kështu që ka vendosur të vijojë seancën dëgjimore të njoftuar për datën 7.9.2021, duke paraqitur rezultatet e hetimit dhe duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit të dërgojë një përfaqësues ligjor, nëse e vlerëson të arsyeshme, kjo nisur edhe nga fakti që subjekti është njohur me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet e saj dhe ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të caktuar edhe një përfaqësues ligjor.

17. Komisioni ka zhvilluar seancën dëgjimore të datës 7.9.2021, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në të cilin subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, si dhe nuk ka qenë prezent as ndonjë përfaqësues ligjor. Në këtë seancë, trupi gjykues, pasi ka relatuar mbi rezultatet e hetimit, të cilat i ishin bërë prezent edhe subjektit të rivlerësimit dhe, për të cilat, kishte dërguar shpjegime dhe prova, ka vendosur të shtyjë këtë seancë për të vijuar në datën 14.9.2021, ora 13:00, për t'i dhënë mundësinë subjektit të paraqesë shpjegimet e saj lidhur me rezultatin e hetimit dhe me barrën e provës.

18. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore vijuese të datës 14.9.2021, ora 13.00, e cila u zhvillua në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar. Në këtë seancë, subjekti paraqiti shpjegimet e saj lidhur me rezultatet e hetimit dhe qëndrimin përfundimtar lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit hapjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të vlerësimit, të figurës dhe aftësive profesionale dhe, në vijim, konfirmimin në detyrë.

## **II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie*, në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

### **A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

20. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstaton se për subjektin e rivlerësimit Adelina Zarka:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;*
- *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

21. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, si vijon:

**1. Shtëpi banimi më sipërfaqe 105 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, e prishur, ndërtuar shtëpia e re me nr. të ri pasurie \*\*\*, me dy kate banimi dhe një kat magazinë, sipërfaqe kati përdhe 345 m<sup>2</sup>, sipërfaqe kati i parë 354 m<sup>2</sup>, sipërfaqe kati i dytë banimi 336 m<sup>2</sup> (sipërfaqe totale 1176 m<sup>2</sup>) me vendndodhje në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Fier, me vlerë investimi në total 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë së bashku me vëllanë e bashkëshortit. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 66.04 m<sup>2</sup> me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me Kontratën e Shitblerjes së datës 17.5.2000, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, realisht shitur në vlerën 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

1.1 Subjekti i rivlerësimit, në deklarinimin fillestar në vitin 2003, deklaroi se ka në pronësi: *“Apartament banimi 3+1 me sipërfaqe totale 220 m<sup>2</sup> e ndodhur në një ndërtesë 3-katëshe në lagjen ‘\*\*\*’, me vlerë investimi nga ana e saj 5.000.000 lekë, pjesa takuese 50% dhe me burim krijimi: të ardhurat financiare janë siguruar nga shitja e një apartamenti të privatizuar në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, e shitur në shumën 4.500.000 lekë”*.

1.2 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Fier, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020, konfirmon pronësinë e ndërtesës me sip. 318.3 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, në pronësi të shtetasit J. Z. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) me dy bashkëpronarë, duke përcjellë edhe dosjen përkatëse.

1.2.1 Nga shqyrtimi i dosjes rezultoi se:

a) Sipas vërtetimit të datës 19.4.2000 në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 19.4.2000, kjo pasuri figuron e regjistruar në emër të shtetasit L. S. Z. (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit), banesë private me sip. 100.5 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”.

b) Në datën 17.4.2000 në emër të shtetasit L. S. Z. është lëshuar leja e ndërtimit nr. \*\*\*, datë 17.4.2000, për objektin magazinë + 2 kate banesë. Leja e ndërtimit është lëshuar në vijim të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.4.2000, të KKRT-së të Bashkisë Fier mbi miratimin e destinacionit të sheshndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij. Në përfundim të punimeve, në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve”, i ndryshuar, është hartuar aktkollaudimi datë 27.4.2004.

c) Kjo pasuri figuron e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\* pasurie, datë 20.7.2005, në emër të shtetasit L. S. Z., me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe sheshi kati përdhe 345 m<sup>2</sup> (1 kat magazinë + 2 kate banimi) në lagjen “\*\*\*\*”.

ç) Me Aktin Noterial nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.10.2017, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë së të ndjerit L. S. Z. dhe në datën 4.1.2018 është regjistruar kalimi i pronës së sipërcituar në emër të shtetasve J. L. Z. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), A. L. Z. (kunati i subjektit të rivlerësimit) dhe N. Z. (vjehtëra e subjektit të rivlerësimit), me pjesë takuese 1/3.

1.2.2 Për sa më sipër, rezultoi se kjo pasuri ka qenë e regjistruar vetëm në emër të babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe pas vdekjes së tij kjo pasuri është trashëguar nga bashkëshorti i subjektit me 1/3 pjesë.

1.3 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, deklaroi se pasuria është ndërtuar me kontributin e përbashkët të familjes së saj dhe vëllait të bashkëshortit dhe se në total ka kushtuar në vlerën 10.000.000 (dhjetë milionë lekë) lekë, nga të cilat ata kanë investuar në vlerën 5.000.000 (pesë milionë) lekë, me pjesë takuese 50% të vlerës. Burimi i krijimit janë të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 66.04 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me Kontratën e Shitblerjes së datës 17.5.2000, në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, realisht shitur në vlerën 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Subjekti ka deklaruar se e ka zotëruar këtë pasuri si dhe e ka deklaruar si adresë banimi në çdo deklaratë periodike vjetore.

1.4 Lidhur me vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit për ndërtimin e kësaj pasurie është bërë krahasimi i saj me vlerën referuese sipas kostove të Entit Kombëtar të Banesave. Referuar vendimit nr. 362, datë 14.7.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit K”, kostoja e ndërtimit për vitin 2001 është në vlerën 22.737 (njëzet e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë) lekë/m<sup>2</sup>. Sipas një llogaritjeje, vlera totale e investimit për këtë pasuri me sipërfaqe totale 1035 m<sup>2</sup> është në vlerën 23.532.795 (njëzet e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë. Nëse kësaj kostoje do t’i zbrisnim vlerën e TVSH-së (20%), si dhe fondin rezervë (5%), në total 25%, vlera shkon 17.649.596 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë (duke mbajtur në konsideratë shpjegimet e subjektit se për punimet e kryera nuk janë paguar fatura me TVSH). Kjo vlerë është llogaritur me rezervë, pasi objekti, sipas të dhënave të rezultuara gjatë hetimit, është ndërtuar në vitet 2000 – 2003.

1.5 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me vlerën e investimit, sqaron<sup>1</sup> se: *“Pavarësisht se sipas EKB-së, vlera e ndërtimit të kësaj banese duhej të ishte 22.000.000-24.000.000 lekë, për ndërtimin e kësaj banese, deri në momentin që kemi hyrë në banesë, familja ime, prindërit e bashkëshortit dhe vëllai i bashkëshortit, kemi investuar deri në vlerën 10.000.000 lekë, kjo është shuma e deklaruar prej meje, pasi kam pyetur prindërit e bashkëshortit, pasi ata kanë mbikëqyrur të gjitha shpenzimet e kryera për investim. Kjo shumë ka rezultuar në gjithë veprimet e pagesave të mbajtura në fletore shënimesh nga prindërit dhe nusja e vëllait të bashkëshortit. Ky ndërtim është zhvilluar gradualisht sipas mundësive financiare, duke filluar punimet në pranverë të vitit 2000 dhe në vitin 2004 është marrë leja e shfrytëzimit duke hyrë në banesë të papërfunduar. Ky ka qenë edhe shkaku i deklarimit të vlerës prej 10.000.000 lekësh, por, sa sipër, sqaruar se zhvillimi i këtij ndërtimi ka vijuar gjatë viteve, madje dhe aktualisht kryhen punime të tjera”*.

1.6 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues/provues mbi vlerën 10.000.000 (dhjetë milionë lekë) lekë të deklaruar prej saj për ndërtimin e banesës trekatëshe, përgjatë viteve 2000 – 2003. Kostoja e ndërtimit, sipas EKB-së, rezulton më e lartë se ajo e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

### **Analiza e burimit të ardhurave.**

1.7 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Dega Fier, ka përcjellë dosjen e apartamentit të banimit me sip. 66.04 m<sup>2</sup>, ku evidentohet:

a) privatizimi nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 4.10.1993, me vlerë 2.413 (dy mijë e katërqind e trembëdhjetë) lekë, shlyer në mënyrë të menjëhershme;

b) shitja e kësaj pasurie me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.5.2000, me blerës shtetasin A. H.. Sipas kësaj kontrate kjo pasuri është shitur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kundrejt vlerës 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, e cila është paguar jashtë zyrës së noterisë. Në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është paguar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit pranë ZVRPP-së Fier tatimi mbi kalimin e të drejtës së pronësisë në vlerën 3.000 (tre mijë) lekë, shumë kjo që përkon me 0.5% të çmimit të shitjes në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë (mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 17.5.2000).

1.8 Subjekti, e pyetur<sup>2</sup> nga Komisioni lidhur me diferencën e çmimit, sqaron se: *“Në vijim të kësaj analize vërtetohet se vlera e banesës sipas kontratës prej 600.000 lekë është thjesht një lapsus. Po kështu, saktësoj se ditën e shitblerjes së banesës, pikërisht në datën 17.5.2000, menjëherë pas marrjes së shumës së lekëve, bashkëshorti i ka arkëtuar pjesën më të madhe të tyre në ‘Tirana Bank’, për t’i tërhequr në vijim sipas nevojave për ndërtimin e shtëpisë. Ky fakt provohet nga statement në ‘Tirana Bank’ bashkëlidhur për llogarinë me nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortit J. Z., sipas së cilës rezulton se data e depozitimit të shumës së lekëve në ‘Tirana Bank’ është e njëjtë me datën e lidhjes së Kontratës së Shitblerjes së kësaj banese data 17.5.2000”*.

1.9 Nga *statement*-i bankar i “Tirana Bank”<sup>3</sup>, për periudhën 1.1.2000 – 31.12.2000, konstatohet se në datën 17.5.2000 janë depozituar në arkë nëpërmjet derdhjes *cash* nga shtetasi J. Z. shumat 3.000.000 (tre milionë) lekë dhe 1.000.000 (një milion) lekë, të cilat janë tërhequr në datën 20.6.2000 në vlerën 1.007.101 (një milion e shtatë mijë e njëqind e një) lekë, në datën 18.8.2000 në vlerën 2.066.353 (dy milionë e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë, si dhe në datën 25.9.2000 në vlerën 1.006.445 (një milion e gjashtë mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë.

1.10 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur<sup>4</sup> gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, lidhur me burimin e të ardhurave për ndërtimin e kësaj pasurie, përveç apartamentit të mësipërm, ka

<sup>1</sup>Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit të datës 7.2.2020.

<sup>2</sup>Shihni përgjigjen nr. 1 të pyetësorit të datës 7.2.2020.

<sup>3</sup>Shih dokumentacionin në pyetësorin standard datë 07.02.2020

<sup>4</sup>Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit të datës 7.2.2020.

deklaruar dhe: (a) hua pa interes në vitin 2000 në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë te shtetasi J. B. (babai i subjektit të rivlerësimit); (b) hua pa interes në vitin 2001 në vlerën 2.000.000 (dy milionë) lekë te shtetasi J. P. (shok i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit); (c) hua pa interesa në vitin 2002 në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë te shtetasi Th. L. (djali i tezës i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit).

1.11 Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur pyetësorit, ka vënë në dispozicion:

a) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.2.2020, me deklarues shtetasit J. N. Bogo dhe Natali Kozma Bogo (prindërit e subjektit të rivlerësimit), të cilët deklarojnë se në vitin 2000 i kanë huazuar vajzës së tyre vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë, për vazhdimin e punimeve për mbarimin e shtëpisë, shumë e kthyer brenda një periudhe 15-vjeçare. Deklaruesi shprehet se burimi i të ardhurave është nga puna familjare.

b) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.2.2020, me deklarues shtetasin J. P. (shok i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), i cili deklaron se: “Në vitin 2000 J. Z. dhe vëllai i tij A. Z. ishin në gjysmë të punimeve për ndërtimin e shtëpisë së tyre në lagjen ‘\*\*\*’, Fier dhe kishin nevojë për një ndihmë financiare për të vazhduar punën. Në këtë kohë i kam dhënë hua shokut tim J. Z. vlerën prej 2.000.000 lekësh për vazhdimin e punimeve për të bërë të mundur mbarimin e shtëpisë”. Deklaruesi shprehet se burimi i të ardhurave është aktiviteti tregtar filiali “\*\*\*” dhe të ardhurat nga dhënia me qira e një ndërtese dykatëshe, shkollë private “\*\*\*\*” për një periudhë 1998 – 2016.

c) Për huan e marrë te shtetasi Th. L., subjekti i rivlerësimit deklaron se e ka shlyer këtë hua dhe në momentin e kthimit të këtij shtetasi nga Greqia do t’i kërkonte konfirmimin nëpërmjet hartimit të një deklarate noteriale.

1.12 Në lidhje me huat e deklaruara më lart nga verifikimi i deklaratës *Vetting* dhe i deklaratave periodike vjetore rezulton se:

a) Subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë si burim krijimi për ndërtimin e kësaj pasurie as në DPV dhe as në deklaratën *Vetting*.

b) Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar kthimin e këtyre huave në deklaratën *Vetting* apo gjatë deklaratave periodike.

c) Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion të kohës për të provuar marrjen e këtyre huave apo kthimin e tyre.

1.12.1 Duke qenë se nuk u gjet asnjë gjurmë lidhur me ekzistencën e tyre duket se janë deklaruar në këtë fazë vetëm për të plotësuar vlerat negative të rezultuara për krijimin e kësaj pasurie dhe, për rrjedhojë, deri në këtë moment këto hua nuk mund të konsiderohen si burim për këtë pasuri.

1.13 Në tabelën nr.1, në vijim është paraqitur analiza ekonomike deri në vitin 2001, sipas afatit të lejes së ndërtimit (shihni pikën 1.5). Në këtë analizë janë marrë në konsideratë edhe të ardhura potencialisht të mundshme të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit që prej viteve 1990, pavarësisht deklaramit të subjektit se burimi ka qenë nga shitja e pasurisë apartament në vitin 2000.

Tabela nr. 1

Analiza financiare për periudhën 1990 – 2001	Vlera sipas deklaramit 10.000.000	Vlera e objektit sipas EKB- së 17.649.596 lekë
Pasuria vilë me sip. 1035 m <sup>2</sup> (50% pjesa takuese)	5.000.000	8.824.798
Të ardhura të dokumentuara	4.417.293	4.417.293
Të ardhurat nga paga	3.817.293	3.817.293
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 66 m <sup>2</sup>	600.000	600.000
Hua të ndryshme	-	-

<i>Shpenzime jetese</i> <sup>5</sup>	2.552.733	2.552.733
<i>Rezultati</i>	-3.135.440	-6.960.238

1.14 Në tabelën nr.2, në vijim është paraqitur analiza financiare, duke konsideruar të ardhurat deri në dhjetor të vitit 2003 dhe duke shtrirë edhe shpenzimet në këtë vit, referuar Deklaratës së Pasurisë për herë të parë, plotësuar dhe dorëzuar në datën 31.3.2004, si dhe dokumentit të lëshuar mbi lejen e shfrytëzimit të vitit 2004.

Tabela nr. 2

Analiza financiare për periudhën 1990 – 2003	Vlera sipas deklarimit 10.000.000	Vlera e objektit sipas EKB-së 17.649.596 lekë
Pasuria vilë më sip. 1035 m <sup>2</sup> (pjesa takuese: 50%)	5.000.000	8.824.798
<i>Të ardhura të dokumentuara</i>	<i>6.339.790</i>	<i>6.339.790</i>
Të ardhurat nga paga	<i>5.739.790</i>	<i>5.739.790</i>
Të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 66 m <sup>2</sup>	<i>600.000</i>	<i>600.000</i>
Hua të ndryshme	0	0
<i>Shpenzime jetese</i> <sup>6</sup>	<i>3.304.165</i>	<i>3.304.165</i>
<i>Rezultati</i>	<i>-1.964.375</i>	<i>-5.789.173</i>

1.15 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, lidhur me këtë pasuri, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për të investuar në ndërtimin e kësaj prone, duke marrë në konsideratë deri në këtë moment vetëm shumët për të cilat janë siguruar dokumenta të vlefshme mbi ekzistencën e tyre.

1.16 Në përfundim konstatohet se:

a) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë shitur pasurinë apartament me sip. 66 m<sup>2</sup> sipas Kontratës së Shitblerjes në vlerën 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë, duke paguar edhe tatimin përkatës mbi të ardhurat e përfituara.

b) Çmimi i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit prej 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh i shitjes së apartamentit, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, nuk rezulton në ndonjë dokument ligjor provues, pasi edhe derdhja në bankë është kryer nëpërmjet derdhjes *cash* nga bashkëshorti i subjektit, por edhe nëse do të ishte i provuar burimi, përsëri ato të ardhura nuk i janë nënshtruar detyrimit mbi tatimin për të ardhurat personale të përfituara nga shitja e një pasurie të paluajtshme.

c) Subjekti i rivlerësimit duhet të provojë burimin e ligjshëm të vlerës 4.000.000 (katër milionë) lekë, të derdhur në “Tirana Bank” nga bashkëshorti.

ç) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti rezultojnë në pamundësi financiare për të investuar në këtë pasuri në vitet 2000 – 2003, me burim të ardhura nga shitja e pasurisë apartament të shitur në vitin 2000, sipas deklarimeve të subjektit.

d) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti rezultojnë në pamundësi financiare, me të ardhura të ligjshme për ndërtimin/investimin e kësaj pasurie edhe nëse merren në konsideratë të ardhurat e tyre për periudhën 1990 – 2003.

dh) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti duket se kanë ndryshuar deklarimet lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për ndërtimin/investimet në këtë pasuri.

e) Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të/bashkëshorti kanë realizuar një kontratë shitjeje në vitin 2000, duke shmangur detyrimin për pagimin e taksave ndaj shtetit.

1.17 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi gjetjet e Komisionit.

<sup>5</sup>Shpenzimet e jetesës janë llogaritur: (1) në periudhën 1990 -1999 janë llogaritur në vlerën 66% të të ardhurave bazuar në vendimin nr. 18, datë 26.7.2019 të KPA-së; (2) në periudhën 2000 - 2003 bazuar në Instat/ILDKPKI.

<sup>6</sup>Shpenzimet e jetesës janë llogaritur: (1) në periudhën 1990 -1999 janë llogaritur në vlerën 66% të të ardhurave bazuar në vendimin nr. 18, datë 26.7.2019 të KPA-së; (2) në periudhën 2000 - 2003 bazuar në Instat/ILDKPKI .

1.18 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar: *“Referuar Udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001, ‘Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave’, ku janë publikuar çmime të konstatuara të tregut të lirë për vitin 2001, pasi në vitet e mëparshme nuk ka të dhëna, çmimi për qytetin e Fierit është 47.073 lekë/m<sup>2</sup>. Në përlllogaritje, referuar këtij udhëzimi vlera për këtë banesë rezulton të jetë 3.106.818 lekë. Po të marrim parasysh që zona ku ndodhet banesa, e cila është zonë qendër në qytetin e Fierit, tregon qartazi që çmimi prej 4.450.000 lekë që kemi shitur banesën është çmimi real”.*

1.19 Lidhur me gjetjen e Komisionit, se çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë të deklaruar nga subjekti nuk i është nënshtruar pagesës së detyrimit tatimor, subjekti i rivlerësimit argumenton se kjo vlerë është paguar dyfish në zbatim të gjobës si masë administrative të caktuar nga ILDKPKI-ja dhe ekzekutuar sipas një vendimi të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë<sup>7</sup>.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se: *“Për sa i përket gjetjes së Komisionit se gjatë realizimit të shitjes së banesës në vitin 2000 i jam shmangur detyrimit për pagimin e taksave ndaj shtetit dhe se masa administrative e caktuar përfundimisht me vendimin e formës së prerë nr. \*\*\*, datë 28.3.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në shumën prej 100.000 lekësh, e paguar prej meje në datën 23.8.2018, nuk mund të legjitimojë të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit, çmoj se përveç faktit, që ky fakt përbën gjë të gjykuar më parë, por dhe nga përlllogaritjet rezulton se masa e gjobës është më e madhe se diferenca e papaguar e tatimit mbi të ardhurat”.*

1.20 Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit që hetimi i kryer nga për këtë pasuri të konsiderohet gjë e gjykuar, pasi për këtë deklarim të pasaktë ka dhënë shpjegime dhe është ndëshkuar nga ILDKPKI-ja me gjobë në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë. Mbi këtë masë administrative, subjekti sqaron se ekziston dhe ka zbatuar vendimin e formës së prerë nr. \*\*\* (\*\*\*) , datë 28.3.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se: *“Në datën 23.8.2018 kam zbatuar vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit duke e shlyer gjobën e caktuar përfundimisht sipas konfirmave bankare, si dhe vendimin e Zyrës Përmbarrimore nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2018. Për pasojë, referuar legjislacionit aktual dhe praktikës së konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, çmoj se ndodhemi para gjësë së gjykuar. Gjykata Kushtetuese ka deklaruar se në harmoni me parimin e sigurisë juridike ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (res judicata) parim që pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar”.*

Subjekti ka cituar vendimin nr. 24/2008, të Gjykatës Kushtetuese ku përcaktohet se: *“Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim që t’i jap jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës”.*

1.21 Lidhur me burimin e të ardhurave nga hua të ndryshme, subjekti sqaron se janë hua pa interes të deklaruar në pyetësorin standard, si burim i shpenzuar prej saj dhe bashkëshortit për ndërtimin e banesës së përbashkët. Sipas subjektit këto hua janë deklaruar nga bashkëshorti në deklaratën periodike për pajisjen me Certifikatë Sigurie të vitit 2033, duke qenë se është subjekt deklarimi i Ministrisë së Brendshme: *“Në kushtet kur këto deklarime, në rekuizitën ‘konfidencial’ janë kryer që në vitin 2003, saktësisht në datën 14.2.2003 prej bashkëshortit/ person i lidhur me mua si subjekt rivlerësimi tek një institucion shtetëror, deklarim i kryer edhe në aplikimet vijuese për pajisjen me certifikatë sigurie pranë DSIK-së e kam konsideruar*

<sup>7</sup>Lidhur me këtë fakt ILDKPKI-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.6.2015, ka caktuar masë administrative gjobë në vlerën 450.000 lekë në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për deklarim të rremë. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të ILDKPKI-së. Por nga ana e kësaj gjykate është rrëzuar kërkesëpadia e subjektit të rivlerësimit. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka apeluar këtë vendimmarrje pranë Gjykatës Administrative të Apelit, e cila nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 28.3.2018 ka shfuqizuar vendimin e ILDKPKI-së sa i takon masës administrative gjobë nga 450.000 lekë në 100.000 lekë. Kjo vlerë është paguar nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet mandatpagesës së “Credins Bank” datë 23.8.2018.



*të ezauruar deklarin e personave prej të cilëve kemi marrë hua si pjesë e të ardhurave për ndërtimin e pjesës së banesës që na takon dhe ku jetojmë aktualisht”.*

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se personat prej të cilëve janë marrë huat dhe janë paraqitur deklarata noteriale kanë pasur aftësi paguese për të huazuar shumat përkatëse. Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion kërkesën drejtuar DSIK-së, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe formularin e plotësuar nga bashkëshorti J. Z., në të cilin deklaroi vlerat e marra hua.

1.22 Subjekti shprehet se gjetjet e Komisionit si mosdeklarim janë thjesht pasaktësi në deklarime prej saj për mungesë të përvojës, trajnimeve apo informacioneve të nevojshme, lidhur me plotësimin e formularëve të deklarimit, sipas kërkesave të neneve 21, 24 dhe 25 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003: *“Këto pasaktësi nuk sjellin asgjë në thelb, pasi nuk kanë të bëjnë me fshehje, por janë thjesht lapsuse në plotësimin e formularit”.*

1.23 Lidhur me situatën negative financiare të rezultuar gjatë hetimit administrativ për krijimin e kësaj pasurie të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting* dhe DPV-të, subjekti ka argumentuar se burimi i të ardhurave të përdorura për këtë pasuri, si investim për pjesën e saj takuese, janë nga shitja e apartamentit në vlerën reale 4.450.000 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe huat e marra pa interes.

Subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“Ky ndërtim është zhvilluar gradualisht sipas mundësive financiare duke filluar punimet në pranverë të vitit 2000 dhe në vitin 2004 është marrë leja e shfrytëzimit, duke hyrë në banesë të përfunduar. Ky ka qenë edhe shkaku i deklarimit të vlerës prej 10.000.000 lekësh”.*

1.24 Subjekti pretendon se për sa i përket kohës së ndërtimit të banesës me prindërit dhe vëllanë e bashkëshortit, Komisioni i është referuar akteve ligjore të vitit 2001, ndërkohë që ndërtimi ka filluar në vitin 2000. Për rrjedhojë, në vijim të përcaktimit të kostove, Komisioni duhet t’u referohet kostove mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2000 dhe vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave po për këtë vit.

1.25 Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se masa administrative e dhënë nga ILDKPKI-ja për deklarim të rremë, si dhe pagimi në vitin 2018 i vlerës përkatëse të gjobës, nuk përmbush kërkesat e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës si dhe nuk legjitimon vlerën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si një e ardhur e ligjshme për krijimin e pasurisë së deklaruar. Gjithashtu, për trupin gjykues mbetet e paprovuar vlera reale e shitjes së kësaj pasurie, e cila rezulton edhe më e lartë se vlera e tregut, po ashtu nuk u gjet as ndonjë lidhje mes shumës së derdhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në bankë në datën 17.5.2000.

1.26 Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për të pranuar si burim edhe huat e deklaruar prej saj gjatë pyetësorëve të Komisionit, trupi gjykues ka vlerësuar se ato nuk janë deklaruar as më parë dhe as në deklaratën *Vetting* dhe se subjekti ka deklaruar si burim për ndërtimin e kësaj pasurie një burim tjetër dhe deklaratat e paraqitura si provë nuk mund të pranohen si të besueshme (në kuptimin e vlerës së tyre provuese). Ky vendim vjen edhe në vijim të një praktike të konsoliduar të vendimeve të ngjashme nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

1.27 Në vlerësim të trupit gjykues, kostoja e llogaritur duke iu referuar çmimeve të vitit 2001 është mesatare dhe oportune referuar edhe shtrirjes së investimit (momentit të fillimit të punimeve dhe përfundimit të tyre), e cila është shoqëruar dhe me llogaritje të shpenzimeve nga Komisioni në një shtrirje përgjatë viteve 2000 – 2003.

Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar se duhet të marrë në konsideratë vlerën e investimit sipas kostove të përcaktuara nga Enti Kombëtar të Banesave në vitin 2001, e llogaritur ajo për 50% të vlerës së pasurisë, sipas deklarimeve të subjektit, rezulton me një balancë negative në vlerën -5.789.173 (pesë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

1.28 Kjo situatë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, e cila përputhet edhe me deklaratimet periodike vjetore (deklaruar rregullisht edhe si adresë banimi edhe përfitimin e të ardhurave nga qiradhënia e disa ambienteve) e vendos atë në kushtet e gërmës “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**2 Të ardhura në shumën 10.036.322** (dhjetë milionë e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzetë e dy) lekë nga dhënia me qira e banesës. Pjesa takuese: 40%.

2.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në Deklarimin Periodik Vjetor të Interesave Private të vitit 2007, pjesën takuese të të ardhurave në emër të bashkëshortit në raportin 4:4:2 nga dhënia me qira e pasurisë, e dhe ka vijuar, më tej, duke e deklaruar këtë të ardhur në çdo vit vijues.

2.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit për Komisionin rezulton se nëpërmjet Prokurës së Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.10.2006, shtetasi L. S. Z. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm me targa dhe kompetenca të plota djalë dhe J. L. Z., për të administruar pasurinë magazinë dhe 2 kate banimi, për të nënshkruar çdo lloj kontrate për këtë pasuri, duke i vendosur vetë kushtet e kontratës, si dhe për të vjelë të ardhurat e qirasë.

2.3 Kontrata e parë me shoqërinë tregtare “\*\*\*\*” sh. a., për dhënien me qira të dy kateve të banimit të kësaj ndërtese është nënshkruar më 1.11.2006, me vlerë 3.200 (tre mijë e dyqind) euro/muaj, ku përcaktohet se: “ ... (a) sipas nenit 7.2 tatimi në burim do të mbahet nga qiramarrësi; (b) sipas nenit 5.2 pagesa do të kryhet nëpërmjet sistemit bankar dhe pagesa do të bëhet në avancë çdo tre muaj, në monedhën lekë me kursin e ofruar nga banka në atë ditë, bazuar në faturën e lëshuar nga qiradhënësi; (c) qiramarrësi është përgjegjës për pagesën e faturave të ujit, dritave, telefonit. Qiradhënësi do të paguajë faturat e këtyre shpenzimeve pranë autoriteteve shtetërore dhe do t’ia ngarkojë koston e tyre qiramarrësit”.

2.3.1 Kjo kontratë është amenduar në vijimësi dhe në datën 3.12.2008 shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., njofton ndërprerjen e kontratës me kushtin që qiraja të paguhej edhe për muajt janar-shkurt 2009.

2.4 Në datën 5.10.2009 është nënshkruar kontrata e re e qirasë mes palëve për të njëjtin objekt dhe të njëjtat detyrime kontraktuale.

2.5 Shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.a., në amendimin e datës 1.11.2010, përveç zgjatjes së afatit ka ndryshuar edhe objektin, duke marrë me qira krahas dy kateve banim të kësaj pasurie edhe magazinën me pagesë 900 (nëntëqind) euro/muaj.

2.5.1 Vlera e qirasë së magazinës nga 900 (nëntëqind) euro/muaj është ulur në 500 (pesëqind) euro/muaj në amendimin e datës 19.5.2015.

2.6 Në datën 22.11.2019, shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.a. njofton shtetasin J. L. Z. se një pjesë e marrëveshjes që përfshin 2 kate banimi do të përfundojë efektive deri në datën 31.12.2019 dhe, pas kësaj date, nuk do të kryhen më pagesa. Magazina do të vazhdojë me të njëjtat terma dhe kushte siç është edhe në kontratë dhe në amendimet përkatëse.

2.7 Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë ka informuar ILDKPKI-në me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2017, se nuk mund të konfirmojë të ardhurat nga qiraja për shtetasin J. L. Z., pasi detyrimi për të deklaruar dhe paguar tatimin në burim është i qiramarrësit.

2.8 Komisioni i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të konfirmuar kryerjen e pagesave të tatimit në burim nga shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh. a. dhe rezultoi se kjo shoqëri ka derdhur tatimin mbi qiratë për objektet e marra prej saj, por nuk evidentohen të dhëna për kontratat konkrete, pasi deri në vitin 2013 nuk ka pasur sistem elektronik të detajuar me të dhëna të ndara, si dhe konfirmon pagimin e tatimit për këto kontrata, përkatësisht, pas vitit 2013 dhe në vijim.

2.9 Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision<sup>8</sup> vërtetimin e datës 21.2.2020, të lëshuar nga shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.a., e cila konfirmon pagesën e tatimit në burim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën tetor 2006 – tetor 2019, në vlerën 8.704.523 (tetë milionë e shtatëqind e katër mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekë.

2.10 Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë rezulton se duke filluar nga tetori i vitit 2006 janë kredituar shumat e qirave në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, si fillim në “Tirana Bank” dhe prej vitit 2007 dhe në vijim në “Raiffeisen Bank”.

2.11 Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision faturat e lëshuara kundrejt shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. për likuidimin e qirasë për periudhën 2006 – 2016, me vlerë totale 50.051.716 lekë. Në këto fatura është specifikuar sipas kontratës: (a) vlera e qirasë *bruto* për periudhën 3-mujore në monedhën euro; (b) kursi i këmbimit i monedhës euro/lekë i konfirmuar nga banka; (c) është zbritur vlera e tatimit në burim dhe vlera *neto* e qirasë është paguar me transfertë bankare nga llogaritë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a. në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

2.12 Shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. ka likuiduar nëpërmjet bankës edhe pagesën e shërbimeve utilitare (ujë, energji elektrike, telefon) për periudhën tetor 2006 – 2016, vlera e të cilave është 3.334.295 (tre milionë e treqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.

### **Të ardhurat e përfituara**

2.13 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* të ardhura në total nga kontrata e qirasë me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., për periudhën nëntor 2006 – 2016, në vlerën 41.452.914 (dyzet e një milionë e katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë, me pjesë takuese të kësaj vlere në masën 40%, pra, në total në vlerën 10.036.322 (dhjetë milionë e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e njëzet e dy) lekë.

2.13.1 Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë dhe faturave të paraqitura nga subjekti, shuma totale e përfituar nga qiraja për periudhën 2006 – 2016 është në vlerën 50.051.716 (pesëdhjetë milionë e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë dhe pjesa takuese e kësaj në vlerën 20.020.686 (njëzet milionë e njëzet mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

2.13.2 Subjekti, e pyetur nga Komisioni lidhur me këtë mospërputhje, sqaron: *“Siç e kam sqaruar edhe më parë, familja ime ka marrë vetëm pjesën prej 40% që na takonte nga ndarja e të ardhurave nga qiraja në raportin 4:4:2. Veprimet financiare sipas kontratës së qiradhënies me shoqërinë ‘\*\*\*’ sh.a., për të gjithë vlerën e pagesës bëheshin nga bashkëshorti im J. Z. , të ngarkuar si përfaqësues me prokurë. Veprimet kryheshin të gjitha dhe vetëm nëpërmjet bankës. Duke qenë se dokumentacioni për sqarimin e kësaj pyetjeje kërkon një kohë relativisht më të gjatë, po ju dërgoj kërkesat drejtuar enteve dhe kompanisë ‘\*\*\*’ sh.a. me qëllim grumbullimin e të dhënave për të dhënë shpjegime shteruese lidhur me këtë pasaktësi”.*

2.14 Në përfundim konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga qiradhënia dhe pjesën e tij takuese nga këto të ardhura të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., duke konfirmuar me shkresë shumën *neto* që i ka paguar qiramarrësit, si dhe konfirmon pagimin e tatimit përkatës.

2.15 Këto të ardhura janë konsideruar të ligjshme dhe janë marrë në konsideratë në analizën financiare të Komisionit në masën 40% si pjesë takuese e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

2.16 Komisioni ka hetuar lidhur me konflikte të mundshme të interesit duke pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, ku subjekti ushtron veprimtarinë si gjyqtare, lidhur me procese të mundshme gjyqësore të gjykuara prej saj me palë ndërgjyqëse shoqërinë tregtare “\*\*\*\*” sh.a. Nga përgjigjet ka rezultuar vendimi nr. \*\*\*, datë 24.7.2018 i gjyqtarës Adelina Zarka me palë kërkuese Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier dhe palë kallëzuese shoqërinë tregtare “\*\*\*\*” sh.a.

<sup>8</sup>Shihni aktet bashkëlidhur pyetesorit të datës 7.2.2020.

2.17 Në përfundim të të dhënave të rezultuara më sipër arrihet në konkluzionin se në periudhën kohore kur është shqyrtuar kjo çështje, shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.a. vijonte marrëdhëniet kontraktuale të qirasë me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit J. Z. për ndërtesën magazinë dhe 2 kate banimi me pagesë 3.200 (tre mijë e dyqind) euro/muaj.

2.17.1 Subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për këtë kontratë, pasi e ka vënë në dispozicion këtë informacion në deklaratën *Vetting* dhe në deklaratimet periodike vjetore.

2.18 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka shqyrtuar çështjen gjyqësore me palë shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., ***për të cilën duket se ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit.***

2.19 Në prapësimet e saj lidhur me gjykimin në rrethanat e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit është shprehur se në veprimtarinë e përditshme ka respektuar me rigorozitet dhe korrektësi vetëm ligjin, referuar edhe Parimeve të Bangalores të Sjelljes Gjyqësore. Në vijim, subjekti shpjegon se kjo marrëdhënie kontraktuale qiraje nuk ka ndikuar në punë, për më tepër në gjykimin e një çështjeje penale të veçantë me objekt pushimin e çështjes për efekt të afateve të parashkrimit.

Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *“Në periudhën që familjarët ishin në marrëdhënie qiraje me shoqërinë ‘\*\*\*\*’ sh.a. dhe unë kam qenë me detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Fier e deri më sot, nuk kam pasur ndonjë raport, proces apo ndonjë marrëdhënie tjetër juridiko-civile me këtë kompani apo me ndonjë tjetër. Për më tepër, gjatë rutinës ditore të punës kam konstatuar edhe raste të ngjashme të çështjeve me palë shoqërinë ‘\*\*\*\*’ sh.a., në të cilat kam deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes”.*

Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion kërkesën për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve me palë “\*\*\*\*” sh.a. në datat 19.6.2020, 13.7.2020 dhe 9.10.2019.

2.20 Në përfundim, trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se subjekti ndodhet në kushtet e germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

**3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, të cilin subjekti i rivlerësimit e deklaroi në deklaratën *Vetting* në pronësi të bashkëshortit:** *“Sipas Kontratës së Shitblerjes së Automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.9.2013, me vlerë 5.000 (pesë mijë) euro”.* Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat nga paga si pedagog në universitetin “\*\*\*\*” (tërhequr nga “Union Bank” më 30.8.2013 sipas *statement*-it përkatës) dhe nga kursimet familjare.

3.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në deklaratimin periodik vjetor të vitit 2013 shpenzime për blerjen e një automjeti tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 5.000 (pesë mijë) euro, por nuk ka specifikuar burimin e këtyre të ardhurave.

3.2 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, ka konfirmuar për Komisionin regjistrimin e automjetit me targa \*\*\*, në emër të shtetasit J. L. Z., duke përcjellë edhe dosjen e automjetit.

3.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se automjeti ka qenë i regjistruar në Gjermani në emër të shtetasit Q. Q. (pala shitëse në kontratë). Sipas deklaratës doganore ky automjet është zhdoganuar më 2.9.2013, në Doganën Fier nga shtetasi Q. Q. dhe detyrimi doganor ka qenë në vlerën 55.607 (pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatë) lekë.

3.4 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka blerë këtë automjet me Kontratën e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.9.2013, me palë shitëse shtetasin Q. Q., në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro, e cila është paguar jashtë zyrës noteriale.

3.5 Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit në vitin 2013 (për më shumë shihni analizën financiare të detajuar).

**4. Kredi në shumën 1.000.000 (një milion) lekë,** në “Intesa Sanpaolo Bank”, të cilën subjekti i rivlerësimit e deklaroi në deklaratën *Vetting* si detyrim financiar me afat 3-vjeçar, me kështë mujor në vlerën 32.275 (tridhjetë e dy mijë e dyqind e shtatë e pesë) lekë. Shuma e detyrimit

financiar deri në datën e fillimit të rivlerësimit është 801.788,07 (tetëqind e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë e shtatë qindarka) lekë.

4.1 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësorin standard të datës 7.2.2020 se në vitin 2016, si rrjedhojë e diagnostifikimit me sëmundje tumorale i është nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale dhe trajtimi mjekësor me kimioterapi në Spitalin Amerikan.

4.2 Subjekti i rivlerësimit është mjekuar dhe kuruar në Spitalin Amerikan për periudhën kohore shkurt - gusht të vitit 2016 dhe ka kryer pagesat e faturave në vlerën totale 379.391 (treqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë. Të ardhurat për mbulimin e shpenzimeve mjekësore janë përballuar nëpërmjet kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit.

4.3 Në përfundim konstatohet se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016, lidhur me shpenzimet për kurimin në Spitalin Amerikan dhe marrjen e një kredie në “Intesa Sanpaolo Bank”, përputhen me pagesat e kryera për koston e mjekimit dhe qëllimin e kredimarrjes, si dhe me deklaratimet në deklaratën *Vetting*.

## **GJETJE TË TJERA**

### **5. Shpenzime për shkollimin e vajzës I. Z.**

5.1 Subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2014, deklaroi si shpenzim: *“Transfertë nga depozita në ‘Raiffeisen Bank’, në emër të shtetasit J. Z. në llogarinë bankare në emër të shtetasve E. dhe I. Z. si garanci bankare për regjistrimin në Universitetin e \*\*\*. Prej kësaj shume është paguar për shkollën shuma 5.488.19 CAD. Shuma e transferuar: 20.490 euro, konvertuar sipas kursit ditor në 30.127 CAD”*.

5.2 Subjekti i rivlerësimit, në DPV-në e vitit 2016, deklaroi si shpenzim: *“Pagesa për shkollën, Universiteti \*\*\*; viti i I, dega Inxhinieri, shuma 7.972,55 CAD. Pagesë për shkollën, Universiteti \*\*\*; viti i II, dega Inxhinieri, shuma 6.000 CAD”*.

5.3 Znj. I. Z., vajza e subjektit të rivlerësimit, gjatë viteve 2014 – 2017, ka ndjekur studimet në degën e Inxhinierisë në Universitetin e \*\*\* në A., Kanada. Sipas një hulumtimi në internet lidhur me tarifat e shkollimit, një vit studimi pranë këtij universiteti për studentët e huaj kushton me përafërsi rreth 12.695 (dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë) CAD.

5.4 Lidhur me të ardhurat për mbulimin e shpenzimeve të studimit të vajzës I. Z., subjekti i rivlerësimit deklaroi në DPV-në e viti 2014 një depozitë të hapur në BKT, në datën 24.12.2014 dhe të mbyllur në po këtë datë (për aplikim për vizë kanadeze) në vlerën 545.302,36 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e treqind e dy e tridhjetë e gjashtë qindarka) lekë, si dhe një depozitë të hapur nga bashkëshorti J. Z. në “Raiffeisen Bank” në datën 6.6.2014 [me qëllim transferimin e shumës 20.490 (njëzet mijë e katërqind e nëntëdhjetë) euro, në llogari bankare në emër të vajzës për qëllime studimi në Kanada].

5.4.1 Për transfertën e sipërcituar dhe për tarifat e shkollimit të deklaruara në DPV-të e viteve 2014 dhe 2016 nga subjekti i rivlerësimit nuk përcaktohet burimi i të ardhurave.

5.5 Subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësorin standard se për vajzën ka mbuluar shpenzimet vetëm për tarifën e shkollimit dhe biletën vajtje-ardhje, pasi qëndrimi, fjetja dhe ushqimi janë marrë përsipër nga vëllai i bashkëshortit A. Z., që është rezident në A., Kanada.

5.5.1 Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, sqaroi se: *“Nëna e bashkëshortit, N. Z., ka marrë të ardhura nga dhënia me qira e shtëpisë që prej momentit të dhënies me qira të banesës, të cilat nuk i ka shpenzuar. Këto lekë tërhiqeshin në ‘Raiffeisen Bank’ nga bashkëshorti im dhe ka qenë pikërisht nëna e tij që ndante pjesët përkatëse. Në momentin kur vajza vendosi të shkonte në shkollë në Kanada nëna i dha shumën e 20.000 eurove”*.

5.5.2 Subjekti i rivlerësimit, krahas përgjigjeve për pyetësorin, ka bashkëlidhur dokumentet si vijojnë: (a) depozitë në llogari personale të shtetasit J. Z., datë 6.6.2014; (b) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.6.2014, me deklarues znj. N. Z.; (c) dokumente nga

Universiteti i \*\*\* mbi pagesat e kryera për shkollimin e shtetases I. Z. ; (ç) vërtetim datë 9.3.2019 mbi punësimin e znj. I. Z. në shoqërinë “\*\*\*\*” për periudhën 28.4 - 26.10.2018; (d) transfertë nga llogaria bankare në “Intesa Sanpaolo Bank” e subjektit të rivlerësimit drejt llogarisë bankare të znj. I. Z. në Kanada, në shumën 250 (dyqind e pesëdhjetë) CAD për shpenzime personale; (dh) vërtetim nga T. M. për pagesat në emër të znj. I. Z. si e punësuar; (e) vërtetim datë 24.1.2017, mbi gjendjen e llogarisë në emër të znj. I. Z. në Royal Bank of Canada; (ë) Deklaratë Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2020 me deklarues z. A. Z..

5.6 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit deklaron në Deklaratën Noteriale nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.6.2014, vënien në dispozicion të shumës 20.000 (njëzet mijë) euro si garanci për studimin e mbesës I. Z., në Kanada, duke shtuar se kjo vlerë është mbyllur në një llogari bankare në emër të shtetasit J. Z.. Subjekti i rivlerësimit nuk e deklaron në deklaratën *Vetting* dhe as në DPV-në e vitit 2014 shumën e dhënë nga nëna e bashkëshortit si burim për pagesën e shpenzimeve të shkollimit të vajzës.

5.6.1 Sipas mandatpagesës datë 6.6.2014, në “Raiffeisen Bank”, të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit rezulton se është derdhur vlera prej 20.000 (njëzet mijë) euro nga shtetasi J. Z. në llogarinë e tij me përshkrimin “nga qiraja e shtëpisë dhënë Bankers”. Kjo vlerë, sipas kursit të këmbimit, është konvertuar në 30.127 (tridhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) CAD.

5.6.2 Sipas *statement*-it datë 23.1.2017, të “Raiffeisen Bank”, konfirmohet se më 6.6.2014 është kryer transfertë nga llogaria e z. J. Z. , në emër të znj. E. Z. , në vlerën 30.127 (tridhjetë mijë e njëqind e njëzet e shtatë) CAD me cilësimin pagesë studimi.

5.6.3 Në transaksionin bankar të datës 18.9.2014 të Royal Bank of Canada pasqyrohet pagesa në shumën 5.488,19 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë e nëntëmbëdhjetë cent) CAD në llogari të Universitetit të \*\*\* dhe gjendja e mbetur në llogari në vlerën 24.520,72 (njëzet e katër mijë e pesëqind e njëzet e shtatëdhjetë e dy cent) CAD dhe nëpërmjet faturës së universitetit konfirmohet pagesa e semestrit të parë në shumën 5.488,19 (pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë e nëntëmbëdhjetë cent) CAD të Universitetit të \*\*\*.

5.6.4 Sipas faturës së datës 3.2.2016 të Universitetit të \*\*\* rezulton kryerja e pagesës në vlerën 7.972,55 (shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy e pesëdhjetë e pesë cent) CAD në emër të znj. I. Z., vlerë që përkon me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016 për pagesën e vitit të parë të studimit të vajzës.

5.6.5 Sipas faturës së datës 23.9.2016 të Universitetit të \*\*\* rezulton kryerja e pagesës në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) CAD në emër të znj. I. Z., vlerë që përkon me deklarimin e subjektit të rivlerësimit në DPV-në e vitit 2016 për vitin e dytë të studimit të vajzës. Nga verifikimi *online* i tarifave të Universitetit të \*\*\* në Alberta, për studentët ndërkombëtarë rezulton se tarifa mesatare e studimit për një vit akademik të jetë në vlerën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) CAD, e cila përputhet me pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit për studimet e vajzës.

5.7 Shtetasi A. Z., nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2020, deklaron se për periudhën 21.8.2014 – 9.2017 ka përballuar çdo shpenzim lidhur me ushqimin dhe qëndrimin në shtëpinë e tij pa pagesë të mbesës I. Z..

5.7.1 Nga verifikimi i adresës së deklaruar nga vajza në autoritetet e taksave rezulton se është e njëjtë me adresën e banimit të shtetasit A. Z..

5.8 Komisioni ka kryer analizën financiare nga rezultati i të cilës ka rezultuar se vajza e subjektit znj. I. Z., në vitin 2015, ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet jetike dhe vëllai i bashkëshortit ka pasur mundësi të përballojë shpenzimet jetike për vajzën e vëllait.

5.9 Në përfundim konstatohet se deklaratat e subjektit të rivlerësimit në DPV-të e viteve 2014 dhe 2016 përputhen me veprimet bankare të kryera, kostot e shkollimit dhe shpenzimet e tjera, si dhe burimi i të ardhurave të përdorura rezulton i ligjshëm.

**6. Të ardhura nga puna e vajzës I. Z.** në Kanada, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: (a) të ardhura nga paga, nga puna si bariste në \*\*\* – shuma e të ardhurave *neto* është 7.176 (shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) CAD; (b) të ardhura nga paga, nga puna si bariste në \*\*\* – shuma e të ardhurave *neto* është 2.146.45 (dy mijë e njëqind e dyzet e gjashtë e dyzet e pesë cent) CAD.

6.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësin standard se vajza I. Z. gjatë kohës së studimeve ka pasur të ardhura minimale *cash* për përdorim vetjak.

6.2 Subjekti i rivlerësimit, në dokumentacionin e vënë në dispozicion për Komisionin, ndër të tjera, ka sjellë historikun e pagesave të vajzës I. Z. . Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se vajza I. Z., gjatë vitit 2016, ka punuar pranë bar “\*\*\*\*” dhe është paguar në total në vlerën 2.293.07 (dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tre e shtatë cent) CAD. Gjithashtu rezulton se vajza I. Z., gjatë vitit 2015, ka qenë e punësuar dhe është paguar në total në vlerën 7.705 (shtatë mijë e shtatëqind e pesë) CAD.

6.3 Rezulton se gjatë periudhës së studimit, vajza I. Z. ka pasur të ardhura *cash* nga puna për përballimin e shpenzimeve vetjake.

**7. Shpenzime për shkollimin e djalit Igli Zarka,** të deklaruara nga subjekti në pyetësin standard, por nuk rezultojnë të deklaruara në DPV-në e vitit 2011.

7.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësin standard se djali i saj I. Z. ka udhëtuar në gusht të vitit 2011 në qytetin \*\*\* në Gjermani për t’u përgatitur për universitetin, duke ndjekur kurse të gjuhës gjermane. Sipas subjektit të rivlerësimit, djali ka udhëtuar drejt Gjermanisë me familjen e kushërirës së saj, ku ka qëndruar si rezident.

7.2 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me shpenzimet për arsimim të djalit I. Z., deklaron në pyetësin standard garancinë monetare për shkollën në Gjermani dhe mbulimin e pagesave për ndjekjen e kursit të gjuhës gjermane.

7.3 Shuma e transferuar: 8.000 (tetë mijë) euro garanci në llogarinë bankare në emër të djalit I. Z. në nëntor të vitit 2011 për shkollën në Gjermani.

7.3.1 Transfertë në vlerat 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) euro dhe 3.000 (tre mijë) euro nga llogaria bankare e z. J. Z. në llogarinë bankare të z. R. K. për mbulimin e shpenzimeve të regjistrimit në shkollë dhe dokumentacionit të djalit I. Z..

7.3.2 Subjekti i rivlerësimit nuk deklaron burimin e të ardhurave për vlerën 8.000 (tetë mijë) euro.

7.4 Subjekti i rivlerësimit, krahas përgjigjeve për pyetësin, ka bashkëlidhur dokumentet që vijnë: (a) njoftim kreditimi në emër të djalit I. Z. në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 11.11.2011; (b) transfertë fondesh për djalin I. Z. nga “Raiffeisen Bank”, datë 29.9.2011; (c) transfertë fondesh për djalin I. Z. nga “Raiffeisen Bank”, datë 31.10.2011; (ç) konfirmim nga Ambasada Gjermane për kryerjen e pagesës për pajisjen me vizë datë 22.11.2011; (d) konfirmim regjistrimi datë 10.11.2011 për ndjekjen e kursit të gjuhës nga \*\*\*; (dh) konfirmim i siguracionit personal për djalin I. Z. nga \*\*\* datë 31.8.2011; (e) vërtetim nga Deutsche Bank, datë 3.11.2011, për transfertat e kryera në llogarinë bankare të djalit I. Z..

7.5 Sipas verifikimit të kryer nëpërmjet sistemit *TIMS* rezulton se shtetasi I. Z. ka dalë nga pika kufitare e Hanit të Hotit me automjetin me targa \*\*\*, në datën 21.8.2011. Hyrja në Shqipëri rezulton në datën 12.11.2011 me automjet nëpërmjet pikës kufitare Morinë.

7.6 Shoqëria gjermane “\*\*\*\*” konfirmon në datën 31.9.2011 pajisjen me policën e siguracionit shëndetësor të shtetasit I. Z., që mbulon periudhën 1.9.2011 - 1.9.2012. Ky konfirmim është dërguar në adresën e banimit të shtetasit R. K. në \*\*\*, ku ishte rezident shtetasi I. Z..

7.7 Shtetasi J. Z. , nga llogaria e tij bankare në “Raiffeisen Bank”, ka kryer në datën 31.8.2011 transfertën në vlerën 3.050 (tre mijë e pesëdhjetë) euro, në llogari të shtetasit R. K. me përshkrimin “transfertë për shkollën”.

7.8 Shtetasi J. Z. nga llogaria e tij bankare në “Raiffeisen Bank” ka kryer në datën 19.9.2011 transfertën në vlerën 650 (gjashtëqind e pesëdhjetë) euro me cilësimin “pagesë shkolle”.

7.9 “Deutsche Bank” konfirmon për shtetasin I. Z. në datën 3.11.2011 transfertat e kryera në numrin e tij të llogarisë bankare në vlerat 3.000 (tre mijë) euro dhe 659 (gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) euro.

7.10 Subjekti i rivlerësimit ka transferuar më 11.11.2011 nga llogaria e saj bankare në llogarinë bankare të djalit I. Z., në “Intesa Sanpaolo Bank” shumën prej 8.000 (tetë mijë) euro. Këto fonde janë tërhequr në muajt në vijim dhe gjatë vitit 2012 *cash* nga djali i subjektit të rivlerësimit.

7.11 \*\*\* (shkolla e kurseve të gjuhës) në \*\*\* konfirmon më 10.11.2011 regjistrimin e shtetasit I. Z. për ndjekjen e kursit të gjuhës gjermane me kohëzgjatje 12.12.2011 - 11.10.2012.

7.12 Ambasada Gjermane në Tiranë konfirmon në datën 29.11.2011 kryerjen e pagesës në shumën 9.000 (nëntë mijë) lekë për pajisjen me vizë gjermane.

7.13 Shtetasi A. Z., në Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.1.2020, deklaroi se në nëntor të vitit 2011 ka ndihmuar vëllanë me shumën 8.000 (tetë mijë) euro, e cila u përdor si garanci për vizën e studimit të z. I. Z. që ndodhej në Gjermani. Në vijim, shtetasi sqaroi se shuma 8.000 (tetë mijë) euro, e vënë garanci, i është kthyer pas. Lidhur me burimin e të ardhurave, ai shprehet se janë marrë nga pjesa e tij takuese e të ardhurave të qirasë që paguheshin nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a.

7.14 Sipas sistemit *TIMS*, djali i subjektit I. Z., pas kthimit në Shqipëri më 12.11.2011 nuk rezultoi të ketë udhëtuar sërish në drejtim të Gjermanisë për ndjekjen e kursit të gjuhës gjermane me afat deri më 11.10.2012.

7.15 Deklarimet e subjektit në pyetësorin standard përputhen me rezultatet e veprimeve hetimore. Shpenzimet janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe rezultoi se ka pasur mundësi për kryerjen e pagesave (për më shumë referojuni analizës financiare).

7.16 Komisioni, gjatë hetimit, është njohur me dokumentin mbi regjistrimin si tatimpagues të shtetasit L. S. Z. (vjehtëri i subjektit), nga i cili rezultoi se kërkesa e shtetasit L. Z. për regjistrim si person fizik është shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga gjyqtarja Adelina Zarka. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.2.2003, ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit L. Z. dhe lejimin e ushtrimit të aktivitetit “bufe-bilardo”.

7.17 Komisioni, në përfundim të të dhënave të rezultuara më sipër, ka arritur në konkluzionin se në periudhën kohore kur është shqyrtuar kjo çështje, subjekti i rivlerësimit ka qenë e martuar me shtetasin J. L. Z. dhe figuron në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit e bashkëshortit, sipas dokumentacionit të Gjendjes Civile Fier, vënë në dispozicion nga subjekti. Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit pohon ushtrimin e një aktiviteti privat nga vjehtëri i saj.

7.18 Subjekti i rivlerësimit duket se e ka shqyrtuar kërkesën e shtetasit L. Z. në kushtet e konfliktit të interesit.

7.19 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar në vijim të rezultateve të hetimit se marrja e vendimit për regjistrimin e personit fizik është në kushtet e një ngarkese optimale pune dhe në vetvete këto fakte nuk mund të përbëjnë cenim të figurës së magjistratit apo cenim të besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

7.20 Trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk duhet ta kishte trajtuar këtë kërkesë me cilësinë e gjyqtarës dhe se ky veprim e vendos në kushtet e germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.



## **8. Nga udhëtimet në sistemin TIMS kanë rezultuar këto të dhëna:**

8.1 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit J. Z. rezulton se në vitin 2005 dhe në vitin 2009 ka udhëtuar jashtë kufijve të Shqipërisë me shtetasin R. Xh., konkretisht, në datat 5.5.2005 - 10.5.2005 në Greqi dhe në datat 16.2.2009 - 18.2.2009 në Kosovë.

8.2 Sipas një të dhëne publike në internet figuron se ky shtetas ka ndryshuar gjeneralitetet e tij nga R. Q. në R. Xh., pasi ka qenë i dënuar më parë.

8.3 Subjekti i rivlerësimit, e pyetur nga Komisioni lidhur me këtë shtetas, konfirmon se R. Xh., mik i ngushtë i bashkëshortit dhe R. Q. janë i njëjti shtetas. Njëkohësisht, subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion një certifikatë familjare të gjendjes civile të shtetasit R. Xh. ku figuron se me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.1996, ka ndryshuar gjeneralitetet nga R. Q. në R. Xh..

8.4 Komisioni i ka kërkuar subjektin të shpjegojë nëse duhet të kish deklaruar këtë kontakt në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

8.5 Në vijim, në prapësime, subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti i është nënshtruar kontrollit të figurës, pasi në vijimësi është pajisur me certifikatë sigurie nga viti 2003 e në vazhdim për kategorinë “konfidenciale” dhe “sekret”. Subjekti argumenton se për efekt të qartësimit të kësaj situatë i është drejtuar zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mbi verifikimin e gjendjes gjyqësore të këtij shtetasi. Sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore nr. \*\*\*, datë 1.6.2021, bashkëlidhur rezulton se shtetasi me gjeneralitetet R. Xh. dhe R. Q. (i njëjti person) dhe është i padënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale.

Subjekti sqaron se ky shtetas është caktuar Konsull Nderi i Republikës së Shqipëri në \*\*\*, si dhe i është akorduar titulli “Ambasador i Kombit”.

Subjekti i ka mbështetur shpjegimet e saj, duke bashkëlidhur si dokument vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shtetasin R. Xh. (R. Q.), printimin e linkut nga faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për konsujt e nderit, si dhe certifikatat e sigurisë të datave 10.5.2016 dhe 4.12.2020, në emër të shtetasit J. Z. .

8.7 Në vijim, trupi gjykues ka vlerësuar të mos përfshijë këtë konkluzion në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit për sa kohë ka vendosur të mbyllë hetimin vetëm për kriterin e pasurisë e se provat për këtë kriter kanë nivelin e provueshmërisë.

9. Nga verifikimi në sistemin e AMF-së nga policia e sigurimit rezulton se shtetasi J. Z. ka qenë përdorues, për periudhën 2010 – 2013, i automjetit tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1993, me targa \*\*\*, në pronësi të shtetasit B. H..

9.1 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor ka konfirmuar regjistrimin e këtij automjeti në emër të shtetasit B. H., duke përcjellë dokumentacionin që disponohet në dosje.

9.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ky automjet është blerë nga shtetasi B. H. me Kontratën e Shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.11.2005.

9.3 Subjekti i rivlerësimit deklaron në pyetësonin standard se para blerjes së automjetit në pronësi të bashkëshortit, kanë lëvizur për probleme familjare me automjetin e miqve të tij.

9.4 Në përfundim konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjëherë në DPV-të e viteve 2010 – 2013 përdorimin e këtij automjeti nga bashkëshorti J. Z. dhe as në pyetësonin

standard të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë lidhjen e bashkëshortit me shtetasin B. H. dhe arsyet e përdorimit të këtij automjeti.

9.5 Subjekti rivlerësimit shpjegon se bashkëshorti nuk ka asnjë lidhje me shtetasin B. H., pasi këtë automjet e ka marrë në përdorim nga shoku i tij I. V. dhe në respektim të legjislacionit në fuqi ka paguar policën e sigurimit në emrin e tij, për aq kohë sa e ka përdorur deri në vitin 2013, kur e ka kthyer sërish. Subjekti i ka mbështetur shpjegimet duke bashkëlidhur Deklaratën Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.6.2021.

9.6 Sipas deklaratës noteriale të mësipërme, shtetasi I. V. deklaroi se është ortak në aktivitetin tregtar “\*\*\*\*” dhe, në rastet kur, nga blerësi nuk paguhet shërbimi i përfituar paguhet në natyrë (*clering*). Në vijim, shtetasi I. V. sqaron se kjo situatë ka ndodhur me automjetin me targa \*\*\*, të cilin ia ka dhënë në përdorim gjatë viteve 2010 – 2013 bashkëshortit të subjektit, me të cilin ka marrëdhënie miqësie personale.

9.7 Nga verifikimi nëpërmjet sistemit të QKB-së figuron se shtetasi I. V. është administrator në subjektin tregtar “\*\*\*\*”.

9.8 Në përfundim, trupi gjykues ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë pasuri (përdorimin e saj) në asnjë deklaram apo pyetësor, duke e konsideruar këtë si një deklaram të pasaktë prej saj.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

22. Në përfundim të gjetjeve dhe rezultateve për kriterin e pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe në përputhje me ligjin, ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar pasuritë e deklaruara prej saj, si dhe gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

23. Trupi gjykues ( shumica ) i vlerëson këto konkluzione si të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe, si pasojë, ndaj saj duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra duke vlerësuar se gjendet në kushtet e germave “a”, “b” dhe “d” të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

24. Në këto kushte, trupi gjykues ( me shumicë votash ) çmoi të panevojshëm hapjen e hetimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Adelina Zarka, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 16.9.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*